



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 86/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Ferizaj, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 30.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

A r s y e t i m

Me datë 29.04.2012, PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV me te cilën pretendohet se në fshatin Nerodime në QV 2505D/05R, janë lejuar 3 raste të votimit familjar. Sipas parashtresës të ankesës krejt kjo është lejuar nga kryesuesi i LDK-së, Shpend Abdullahu edhe përkundër vërejtjeve të vëzhguesve të LVV-së. Me këtë rast, sipas parashtresës të ankesës është bërë shkelja e nenit 89.3 të LZP-së dhe neni 178 i Kodit Penal.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës se janë lejuar 3 raste të votimit familjar pa i identifikuar në asnjë moment se cilët kanë qenë ata persona që janë lejuar të votojnë në mënyrë familjare, për të cilin rast pretendohet nga pala ankuese se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkaku se në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë dëshmi për tu vërtetuar se kanë ndodhur shkeljet e pretenduar në ankesë, PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 86/2012 më datën 30.04.2012.

